

---

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“EROT GROUP”**

---

## KREU I

### EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA

#### NENI 1. KRIJIMI, EMËRTIMI I SHOQËRISË

**1.1** Shoqëria "EROT GROUP" është person juridik i së drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**1.2.** Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare.

#### NENI 2

#### SELIA

**2.1** Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Jordan Misja, Zona Kadastrale Nr. 8330, Nr pasurie 6/638-N15, Tiranë.

**2.2** Me vendim të Asamblesë mund të hapë zyra përfaqësie, degë, dhe/ose të krijojë filiale brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### NENI 3

#### KOHËZGJATJA

**3.1** Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të papërcaktuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, duke filluar nga rregjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

#### NENI 4

#### OBJEKTI I SHOQËRISË

**4.1** Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti:

- Import-eksport, tregtimi dhe shitja me shumicë dhe pakice e një gamë të gjërë produktesh, parfumerie, kozmetike, tekstile, shëndeti, dentare, si dhe produkte import-eksport me pakicë dhe shumicë të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, pije. Tregtimi i artikujve të ndryshëm.

**4.2** Për të arritur objektin të saj, Shoqëria, me vendim të Asamblesë mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.

**4.3** Shoqëria, dhe më qëllim arritjen e objektit te saj, mund te lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që do ta konsiderojë të nevojshëm.

## **KAPITALI PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË**

### **NENI 5 KAPITALI THEMELTAR**

**5.1** Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 (një mijë mijë) Lek, i ndarë në 1(nje) kuote. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **NENI 6 ORTAKËT**

**6.1** Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët:

- ***Fitore Radogoshi***, shtetase Kosovare, lindur më datë 18/10/1990, në Gjakovë, identifikuar me ID1412772, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë 1,000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

### **NENI 7 TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**7.1** Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.



Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**7.2** Kuotat janë lirisht të transferueshme pa miratim paraprak të asamblesë së ortakëve.

**7.3** Transferimi i kuotave duhet të realizohet në përputhje me ligjin dhe të regjistrohet në QKR sipas parashikimeve ligjore.

## **NENI 8 FINANCIMI I SHOQËRISË**

**8.1.** Shoqëria me qëllim arritjen e objektit të saj, do të kërkojë financimin nëpërmjet mënyrave ligjore si kredi bankare, hua, financim nga ortakët dhe çdo formë tjetër ligjore.

## **NENI 9 ORGANET E SHOQËRISË**

**9.1** Organet e Shoqërisë janë:

- Administratori
- Asambleja e Ortakëve

## **NENI 10 ADMINISTRATORËT FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE**

**10.1** Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator. Administratori është i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet tregtare të shoqërisë pa kufizim kompetencash, përvèç atyre që ligji, akti i themelimit dhe statuti ja ngarkon Asamblesë se Ortakëve.

**10.2** Administratori i shoqërisë kryen administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë. Shoqëria ka si administrator **znj. Fitore Radogoshi**, shtetase Kosovare, lindur më 18/10/1990 në Gjakovë, me nr ID 1412772, banues në Tiranë, e pajisur me lejeqëndrim të përhershëm me nr ID: J09018002S.

**10.3** Administratori ka të gjitha kompetencat për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Ai vepron në emër të shoqërisë dhe nënshkruan çdo dokument të shoqërisë. Administratori nuk ushtron kompetencat që ligji ose aktet e shoqërisë ja japid shprehimisht Asamblesë së Ortakëve. Administratori emërohet për një afat **5 vjeçar** me të drejtë rizgjedhje.

**10.4** Administratori mund të autorizoj një person të kryejë veprim në QKR si depozitim aktesh, vendimesh, bilance, statutit dhe çdo akte tjetër.

**10.5.** Administratori përfiton shpërbllim/pagesa për punën e tyre me në masën e përcaktuar me vendim të asamblesë së ortakëve.

**11.6.** Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:



- a) kryejnë të gjitha veprimet e administritimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividentë
  - c) u shprëndan aktivet shoqërisë
- ç) lejon që shoqëria të vazhdoj veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikoje që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese per të shlyer detyrimet
- d) jep kredi

Përvec padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtën të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë dhe dëmshpérblimin finaniar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## NENI 11 ASAMBLEJA E ORTAKËVE

**11.1.** Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje që ligji ose ky statut ia rezervon asaj. Vendimet e Asamblesë janë të detyrueshme të zbatohen nga organet e shoqërisë.

**11.2.** Mbledhjet e Asamblesë se Ortakëve organizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**11.3.** Asambleja zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe vendos në mënyrë të rregullt sipas kuorumi të parashikuar nga ligji.

**11.4.** Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen normalisht në selinë e shoqërisë por, me vendim të sajin Asambleja mund të mblidhet edhe ne një vend tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.

**11.5.** Ortakët njoftohen për mbledhjen e asamblesë të paktën 7 ditë përpara dhe duhet të marrin njoftimin për datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe të marrin kopjen e dokumenteve që lidhen me rendin e ditës.

**11.6.** Mbledhjet e Asamblesë se Ortakëve mund të thirren nga Administratori/administratorët, ose nga subjekte të parashikuar në ligj.

**11.7.** Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfarë do banke apo institucion financier kreditor
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një përsone i tretë.

Administratori i shoqërise nuk mund të veprojë si përfaqësues i orakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin mbledhjet vijuese me të njejtin rend ditë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### **11.8 Mënyra e thirrjes**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo nuk mund të marrë vendime të vlefshme.

### **11.9 Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendor në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njejtin rend dite.

### **11.10 Marrja e vendimeve**



1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit Për Shoqëritë Tregtare, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit Për Shoqëritë Tregtare, Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si:
  - a) përcaktimin e politikave tregtarë të shoqërisë;
  - b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
  - d) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë pasqyrën financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërise në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet skedën e shoqërisë.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

#### **11.11 Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**NENI 12**  
**VITI FINANCIAR**

**12.1.** Viti finanziar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

**12.2.** Bilanci i shoqërisë mbahet në përputhje me ligjin, miratimi dhe cdo veprim tjetër merret në përputhje me parashikimet ligjore.

**NENI 13**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

**13.1.** Procedura e likuidimit e parashikuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” zbatohet në rastin e prishjës së shoqërisë.

**13.2.** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsyet tjerat, të parashikuara në statut ose në legjisacionin shqiptar.


Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 14**



## LIGJI I ZBATUESHËM


**14.1.** Shoqëria do te kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut dhe me parashikimet e ligjeve shqiptare. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut do të zbatohet ligji shqiptar nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**14.2.** Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare

**14.3.** Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet në 5 kopje origjinale sot më 01/03/2023, në Tiranë.

**Ortaku i vetëm i shoqërisë**

**Fitore Radogoshi**

Handwritten signature of Fitore Radogoshi in blue ink, consisting of the name "Fitore Radogoshi" followed by a stylized signature below it.